

## AKT THEMELIMI

### PER SHOQERINE " Logan & A.D " SH.P.K.

Sot me daten 03/05/2023, ortaket themelues:

1. Artur Haxhi I datelindjes 20.08.1984, lindur ne Vlore dhe identifikuar me nr id. I40820110L,

Me vullnetin e tyre te lire themelojne shoqerine me emertimin: "Logan & A.D" SH.P.K. me seli ne, KAVAJE; ; Golem; KARPEN; Rruga Karpen Golem Kavaje, Zona Kadastrale 2099, pasuria nr.10/90, Struktura turistike 1-2 kat+ 1 kat nentoke pra shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

Vula e shoqerise permban emertimin "Logan & A.D "shpk dhe Logon e Shoqerise.

Shoqeria krijohet me mjetet financiare prone e ortakeve themelues:

1. Artur Haxhi ne masen 100,000.00 lek e cila perben 1(nje) kuote te shoqerise ne masen 100% te kapitalit.

Kapitali themeltar I shoqerise do te jete 100,000.00 lek. Shume e cila do te ngurtesohet ne bank ne momentin e rregjistrimit te shoqerise.

Kjo shoqeri ka statusin e personit juridik shqiptar dhe i nenshtrohet legjislacionit perkates shqiptar. Afati i veprimtarise se saj do te jete i papercaktuar. Ky afat mund te zgjatet dhe mund te shkurtohet ne rastet kur shoqeria do te shperbehet sipas percaktimeve qe pasqyrohen ne statut.

#### **Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:**

-Bar, restorant ,hoteleri.

Organi me larte drejtues kesaj shoqerie tregtare do te jete Asambleja e Ortakeve te shoqerise. Shoqeria administrohet nga administratore qe mund te jene te dy ose njeri nga ortaket ose nje person tjeter.

Kompetencat e administratorit caktohen ne statut. Me themelimin e ketij akti, bashke administrator te shoqerise caktohen Z. Artur Haxhi me nr ID. I40820110L per nje periudhe 5 (pese) vjecare me te drejte rizgjedhjeje ne kete detyre.



Ne kete shoqeri mund te aderojne ortake te tjere te rinj ne kushtet qe do te percaktohen ne aktmarrveshjen e bere ne rastin e pranimit te tyre. Po ashtu asambleja e ortakeve ka te drejten te ndryshoje ose shtoje objektin e veprimtarise se shoqerise sipas interesave te veta ekonomike dhe financiare.

Shoqeria ka te drejte te punesoje specialist te fushes qe i perket objektit te veprimtarise si dhe punonjes te tjere me kontrate pune sipas percaktimeve ne Kodin e Punes dhe pergjithesisht me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Do te konsiderohen veprimtari te shoqerise vetem ato veprime juridiko-civile qe do te kryhen nga organet e saj conform disponimeve ne statutin dhe ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi.

Si rregull veprimet ekonomike te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti, perjashtim nga ky rregull do te behet kur kerkon organi kompetent ligjor.

Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis ortakut te vetem, administratorit dhe personave te tjere te punesuar ne shoqeri ne rast se nuk zgjidhen me pajtim do te zgjidhen nga gjykata kopetente.

Fitimi i nxjerre nga aktiviteti i ligjshem i kesaj shoqerie tregtare eshte ne favor te ortakeve te shoqerise ne masen 100%.

Nderkohe ortaket mbartin mbi vete rrezikun e humbjes deri ne masen 100% (njqind per qind) te kapitalit themeltar dhe atij rezerve.

Per detyrimet qe shoqeria mund t'ju kete personave te tjere juridike apo fizike pergjigjet me mjetet e veta financiare dhe materiale.


Per funksionimin normal te shoqerise do te hartohet statuti I shoqerise ku do te parashikohen hollesite e mirefunksionimit dhe administrimit te saj.

Veprimataria e saj private ushtrohet brenda territorit te Republikes se Shqiperise. Kjo shoqeri mund te mbylle aktivitetin e vet ne rastet e parashikuara ne legjislacionin shqiptar dhe ne statutin e saj.

Shoqeria do te marre personalitet Juridik me rregjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Ky aktthemelimi hartohet ne 2 (dy) kopje.

Nje kopje e aktit te themelimit se bashku me statutin e shoqerise, ruhen ne QKB.



"ORTAKET THEMELUES"

ARTUR HAXHI

Artur Haxhi

